

**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"MEDISON PHARMA ALBANIA" SH.P.K**

Sot më datë 05.07.2021, në Tiranë, u paraqit pala e mëposhtme:

- MEDISON PHARMA TRADING AG, një shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Zvicrës, me seli në Bahnhofstrasse 18, CH-6300, Zug, Zvicër, ligjërisht e përfaqësuar nga Z. Artur Asllani, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 12.08.1973, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036542505, siç është autorizuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve të MEDISON PHARMA TRADING AG, datë 22.06.2021.

Pala e mësipërme ka vendosur të nënshkruajë këtë statut të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe ky Statut.

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1 Shoqëria "MEDISON PHARMA ALBANIA" Sh.p.k (këtej e në vijim referuar si "Shoqëria") është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria kryen aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "MEDISON PHARMA ALBANIA" Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti**

- 3.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë si më poshtë:
  - a) aktivitete biznesi dhe aktivitete të tjera konsulence në fushën e menaxhimit;
  - b) aktivitete të agjencive reklamuese;
  - c) kërkimi i tregut dhe sondazhe të opinionit publik;
  - d) organizimi i konventave dhe eventeve tregtare.
- 3.2 Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çfarëdolloj veprimtarie në lidhje me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, industrial ose ndonjë aktivitet tjetër, që mund të konsiderohet i dobishëm në lidhje me përmbushjen e objektivave të saj.

**Neni 4 – Selia**

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Mihal Popi, Vila 8, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Selia e Shoqërisë mund të transferohet në një adresë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



- 4.3 Asambleja e Përgjithshme mund të krijojë degë dhe/ose zyra përfaqësie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

- 5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.
- 5.2 Kohëzgjatja e Shoqërisë mund të prishet me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **KAPITULLI II KAPITALI, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT**

#### **Neni 6 –Kapitali**

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është EUR 3,000 (tre mijë euro).
- 6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, plotësisht e nënshkruar nga ortaku i vetëm.

#### **Neni 7 – Kontributet dhe pjesët e kapitalit**

- 7.1 Kontributi në kapital do të jetë si më poshtë:
- MEDISON PHARMA TRADING AG do të paguajë një shumë prej EUR 3,000 (tre mijë euro), e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet pagimit të shumës së mësipërme në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 7.2 Bazuar në kontributet e mësipërme:
- MEDISON PHARMA TRADING AG do të zotërojë 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Zmadhimi i kapitalit**

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet pa ndonjë kufizim, dhe më shumë se një herë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2 Në rastin e zmadhimit të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë për zmadhimin në përpjesëtim me pjesët e tyre të kapitalit. Në rastin kur ndonjë nga ortakët nuk heqin dorë nga e drejta e tyre, pjesët e tyre të kapitalit mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në përputhje me pjesët e tyre respektive të kapitalit.

#### **Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit**

- 9.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Ortakët përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

#### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Ortaku që dëshiron të transferojë kuotat në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa



shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, duhet më parë t'ia ofrojë ato në parablerje ortakëve të tjerë.

- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatin e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT, EKSPERTI KONTABËL I REGJISTRUAR**

#### **Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet në lidhje me çështjet e mëposhtme: ndryshimet e Statutit, emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuidatorëve, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë, miratimin e buxhetit dhe çdo çështje tjetër të patashikuar nga ky Statut dhe ligji i zbatueshëm.

#### **Neni 12 – Mbledhjet, kuorumi dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme do të thirret nga Administratori/rët ose nga Ortaku i Vetëm.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet sa herë do të jetë e nevojshme sipas interesave të Shoqërisë ose ligjit të zbatueshëm. Në çdo rast, mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se muaji Qershor i çdo viti me qëllim diskutimin, analizën dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit të kaluar financiar.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret në qoftë pasqyrat financiare vjetore ose të ndërmjetme tregojnë ose kur është e dukshme se humbjet arrijnë në 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, ose ekziston rreziku që asetet e Shoqërisë nuk do të mbulojnë detyrimet e saj brenda 3 (tre) muajve të ardhshëm.
- 12.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet postës rekomande me kthim përgjigje ose postës elektronike të dërguar ortakut/ve në vendbanimin e komunikuar me shkrim Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara ditës së caktuar për mbledhjen.



- 12.5 Njoftimi i mbledhjes duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë së Përgjithshme, rendin e ditës që do të diskutohet, vendin e mbledhjes, kohën dhe ditën e thirrjes së parë dhe të dytë. Asambleja e Përgjithshme nuk do të diskutojë një çështje e cila nuk është e përfshirë në rendin e ditës. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme nuk do të ndryshojë pa një njoftim të dytë.
- 12.6 Në qoftë se Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbahet gjatë thirrjes së parë për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm, mbledhja do të mbahet në një thirrje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga thirrja e parë.
- 12.7 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në një vend tjetër të ndryshëm nga selia, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.
- 12.8 Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet me audio ose videokonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të; mbas verifikimit të këtyre kërkesave të cilat do të paraqiten në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku janë të pranishëm së bashku Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.
- 12.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur dhe e mbledhur në mënyrë të vlefshme edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm dhe që të gjithë ortakët e pranishëm pranojnë të vazhdojnë mbledhjen.
- 12.10 Ortaku mund të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht ortak, i pajisur me një prokurë. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble të Përgjithshme dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të së njëjtës Asamble.
- 12.11 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar vetëm për një pjesë të kapitalit së zotëruar prej tij kur është personalisht i pranishëm për të votuar për pjesën e mbetur.
- 12.12 Administratori/ët dhe Eksperti Kontabël mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme.
- 12.13 Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme do të kryesohet nga një ortak ose nga një person tjetër i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme. Sa herë që prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme emëron një sekretar, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë një ortak.
- 12.14 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme duhet të verifikojë vlefshmërinë e pjesëmarrjes së ortakëve, të verifikojë rregullsinë e thirrjes/ve dhe rregullsinë e mbledhjes. Kryetari i mbledhjes vendos rendin e diskutimeve dhe procedurat e votimit.
- 12.15 Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohet në procesverbal dhe të nëshkruhet nga kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/rët është përgjegjës për mbajtjen e një kopje të procesverbalit.
- 12.16 Procesverbali duhet të përmbajë: vendin dhe datën e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe personin që mban listë prezencën, rezultatet e votimit, vendimet e marra, deklaratën e kryetarit në lidhje me procesin vendimmarrës.
- 12.17 Lista e pjesëmarrësve do të bashkangjitet procesverbalit si dhe dokumentacioni në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.



- 12.18 Proçesverbali dhe lista e pjesëmarrësve do të nënshkruhen nga kryetari dhe nga personi që mban listën e e pjesëmarrësve.

### **Neni 13 – Administratori/rët**

- 13.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të cilët do të veprojnë së bashku. Përveçse kur Asambleja e Përgjithshme i shkarkon nga detyra apo ata japin dorëheqjen, administratorët janë të emëruar për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet. Administratorët mund të riemërohen.
- 13.2 Administratorët do të përfaqësojnë Shoqërinë përballë palëve të treta që i nënshtrohen dhe në zbatim të kushteve dhe dispozitave të përcaktuara në pikën 13.3 më poshtë dhe/ose aktit të emërimit do të kenë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveç kompetencave që Statuti apo ligji ia rezervon organeve të tjera të Shoqërisë.
- 13.3 Administratorit/ve të Shoqërisë do t'u jepen kompetenca specifike. Për këtë qëllim, Administratorët do të kryejnë çdo transaksion, të lidhin, rinovojnë, përfundojnë çdo marrëveshje ose kontratë, të ndërmarrin çdo veprim, detyrim, sipërmarrje, të kryejnë ndonjë veprim tjetër, në çdo rast, secila prej të tyre deri në vlerën prej EUR 100,000 (njëqind mijë euro) ose në shumën ekuivalente në valutë tjetër. Për çdo transaksion, marrëveshje, kontratë, veprim, detyrim dhe sipërmarrje tjetër që e tejkalon vlerën e lartpërmendur, kërkohet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.4 Administratori/rët do të kryejë detyrën/rat e tij/të tyre dhe veprimtaritë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe me aktet e Shoqërisë.

### **Neni 14- Eksperti Kontabël i Regjistruar**

- 14.1 Në rast se është e nevojshme ose kërkohet nga ligji ose me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilancit dhe i librave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga një ose disa eksperte kontabël të regjistruar.
- 14.2 Eksperti kontabël i regjistruar do të ketë përgjegjësitë e parashikuara në ligjin e zbatueshëm.

## **TITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 15 – Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 15.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit.
- 15.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- 15.3 Bilanci vjetor, llogaritë financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 15.4 Dokumentat që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### **Neni 16 – Fitimet**

- 16.1 Fitimi që rezulton nga bilanci vjetor pasi të jetë zbritur 10% (dhjetë përqind) për rezervën ligjore të kapitalit të Shoqërisë, dhe pasi janë zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që



Asambleja e Përgjithshme vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në të njëjtën masë me kuotat e zotëruara prej tyre.

- 16.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

## TITULLI V PRISHJA DHE LIKUJDIMI

### Neni 17 – Prishja

Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ose në rastet e parashikuara nga ligji.

### Neni 18 – Likuidimi

- 18.1 Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 18.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 18.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'u shpërndajnë Ortakëve fitimin që mbetet pas likuidimit, në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruar prej tyre.

## TITULLI VI TË NDRYSHME

### Neni 19 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 19.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin apo që lidhen në një mënyrë ose tjetër me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e këtij Statuti, ndërmjet ortakëve (përveç mosmarrëveshjeve që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë) ose ndërmjet një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen drejtpërdrejt e me mirëkuptim ndërmjet palëve të interesuara.
- 19.2 Në qoftë se nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

### Neni 20 – Gjuha

Ky Statut nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Për çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akti, versioni anglisht do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.


\*\*\*

ORTAKU



Për MEDISON PHARMA TRADING AG

PËRKTHYESE





**ARTICLES OF ASSOCIATION  
OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY  
"MEDISON PHARMA ALBANIA" SH.P.K**

Today, on July 5th, 2021, in Tirana, the following Party appeared:

- MEDISON PHARMA TRADING AG, a company incorporated and existing under the laws of Switzerland, with registered address at Bahnhofstrasse 18, CH-6300, Zug, Switzerland, legally represented by Mr. Artur Asllani, Albanian citizen, born in Tirana, Albania, on August 12, 1973, resident in Tirana, Albania, holder of the Albanian ID no. 036542505, as empowered through the resolution of Board of Directors of MEDISON PHARMA TRADING AG, dated June 22, 2021.

The above mentioned Party has decided to stipulate these Articles of Association of a limited liability company, whose activity will be regulated by the Albanian legislation in force and the present Articles of Association.

**TITLE I  
COMPANY'S FORM, NAME, OBJECT, REGISTERED OFFICE, DURATION**

**Article 1 – Form**

- 1.1. The Company "MEDISON PHARMA ALBANIA" Sh.p.k (hereinafter referred as the "Company") is established as a limited liability company, and regulated by the present Articles of Association and the Memorandum of Incorporation.
- 1.2. The Company carries out its activity pursuant to the Albanian legislation in force.
- 1.3. The Memorandum of Incorporation and the Articles of Association are in compliance with the mandatory Albanian legislation and the matters not expressly provided hereto shall be governed by the Albanian law.

**Article 2 – Name**

The name of Company is "MEDISON PHARMA ALBANIA" Sh.p.k.

**Article 3 – Object**

- 3.1 The object of Company's activity shall be the following:
  - a) business and other management consultancy activities;
  - b) advertising agencies' activities;
  - c) market research and public opinion polling;
  - d) organization of conventions and trade shows.
- 3.2 In addition, in compliance with the Albanian legislation, the Company may carry out any transaction related to the movable or immovable properties, as well as any commercial, industrial or other activity, which may be either necessary, useful or auxiliary to the foregoing purposes.

**Article 4 – Registered Office**

- 4.1 The registered office of the Company is in Rr. Mihal Popi, Vila 8, Tirana, Albania.
- 4.2 The Company's registered office can be transferred to another address by resolution of the General Meeting.
- 4.3 The General Meeting can also establish branches and/or representative offices within the Republic of Albania and/or abroad.



## **Article 5 – Duration**

- 5.1. The duration of the Company is unlimited.
- 5.2. The Company may be terminated by a resolution of the General Meeting.

## **TITLE II CAPITAL, INCREASE AND REDUCTION OF CAPITAL AND TRANSFER OF QUOTAS**

### **Article 6 –Capital**

- 6.1. The Company's capital is EUR 3,000 (three thousand euro).
- 6.2. The Company's capital consists of 1 (one) quota, fully subscribed by the sole quotaholder.

### **Article 7 – Contributions and quotas**

- 7.1. The contributions in the capital shall be as follows:
  - MEDISON PHARMA TRADING AG shall pay an amount of EUR 3,000 (three thousand euro), representing 100% (hundred per cent) of the Company's capital.
- 7.2. Based on the above mentioned contributions:
  - MEDISON PHARMA TRADING AG shall own 1 (one) quota, representing 100% (hundred per cent) of the Company's capital.

### **Article 8 - Increase of capital**

- 8.1 The Company's capital may be increased, without any limit and more than once, by resolution of the General Meeting.
- 8.2 In case of increase of capital, all quotaholders have the right to subscribe the increase in proportion to their quotas in the capital. In case any of the quotaholders will not exercise his right, his quotas may be subscribed by the other quotaholders in proportion to their respective quotas.

### **Article 9 – Reduction of capital**

- 9.1 The Company's capital may be reduced by resolution of the General Meeting. In any case the Company's capital may not be reduced under the limit provided by the law.
- 9.2 The quotaholders afford the reduction of the Company's capital in proportion to their quotas in the capital.

### **Article 10– Transfer of quotas**

- 10.1 The quotas of capital are freely transferred between the quotaholders.
- 10.2 The quotaholder who intends to transfer his quotas in any kind, whether for consideration or free of charge in the broadest sense of the term, also including the donation of the quotas to parties other than quotaholders, must offer them first to the other quotaholders.
- 10.3 In this case, the quotaholder who intends to transfer his quota shall give written notice to the other quotaholders, via registered mail return receipt verified, informing them on his decision to transfer the quota, indicating the price, conditions, terms, name of the buyer and the term of transfer. The right of first refusal shall be, in any case, referred to all offered quotas.



- 10.4 The quotaholders shall have 15 (fifteen) days, from the receipt of the notice, to communicate to the quotaholder who intends to transfer the quotas on their decision whether to exercise or not the right of first refusal. If a quotaholder does not answer within the indicated term, his right of first refusal is considered as waived.
- 10.5 If the offer is accepted by more than one quotaholder, the quotas offered by the quotaholder who intends to transfer the quotas are distributed in proportion to their respective quotas, unless otherwise agreed between the parties. The quotaholder accepting the offer cannot exercise the right of first refusal partially.
- 10.6 In case the right of first refusal is not exercised, the quotas may be transferred to third parties, entirely or in part.

**TITLE III**  
**GENERAL MEETING, ADMINISTRATORS, PUBLIC CERTIFIED ACCOUNTANT**

**Article 11 – General Meeting and its powers**

- 11.1. The decision-making body of the Company is the General Meeting.
- 11.2 The General Meeting is responsible for decisions regarding the following matters: amendments to Articles of Association, appointment and removal of administrators, accountants and liquidators, increase and reduction of the capital, profit distribution, reorganization and dissolution of the Company, budget approval and any other matter stipulated by these Articles of Association and applicable law.

**Article 12 – Convening, quorum and resolutions of General Meeting**

- 12.1 The General Meeting shall be convened by the Administrator/s or the Sole Quotaholder.
- 12.2 The General Meeting shall be convened as often as necessitated by the Company's interests or applicable law. In any case, the ordinary General Meeting shall be called at least once a year in a regular session, within month of June of each year at the latest, for the purpose of discussing, examining and approving the annual statement of accounts of the previous financial year.
- 12.3 The General Meeting must be convened, if annual or interim statements of account indicate or if it is obvious that losses amount to 50% (fifty per cent) of the capital, or if there is a risk that the Company's assets will not cover its liabilities within the next 3 (three) months.
- 12.4 The call of the General Meeting should be made through registered mail or electronic mail with return receipt sent to the quotaholder/s at the domicile indicated in writing to the Company, at least 7 (seven) calendar days before the day set for the meeting.
- 12.5 The convening notice must contain information on the type of the General Meeting, the agenda to be discussed, venue, time and day of the first and second call. The General Meeting shall not address an issue not included in the agenda. The agenda of the General Meeting shall not be changed upon a second notification.
- 12.6 If the General Meeting cannot be held in the first call due to the absence of the necessary quorum, the meeting shall be held in second call within 30 (thirty) calendar days from the first call.
- 12.7 The General Meeting may be held in a location other than the registered office, within the Republic of Albania or abroad.



- 12.8 The General Meeting may be held also via audio or videoconference, provided that all participants are identified by the chairman and they are given the possibility to follow the discussion and actively participate in it; after the verification of these requirements which should be displayed in the minutes of the meeting, the General Meeting shall be considered as held in the place where both the chairman and the secretary of the meeting are present.
- 12.9 The General Meeting shall be deemed duly convened and established notwithstanding all the formalities governing the calls are not observed, provided that the entire Company's capital is present and all quotaholders present in the meeting agree to proceed with the meeting.
- 12.10 The quotaholder may be represented by another person, not necessarily quotaholder, by a written proxy. In any case, the proxy may be given for one General Meeting only, and it is valid for its first and second call.
- 12.11 The quotaholder may not issue a proxy to vote for a share of its participation when personally voting for the remaining share.
- 12.12 The Administrator/s and the Public Accountant/s may participate in the General Meeting.
- 12.13 Each General Meeting shall be chaired by a quotaholder or another person appointed by the General Meeting. Whenever the presence of a recording notary public is not estimated, the General Meeting appoints a secretary, who must not necessarily be a quotaholder.
- 12.14 The chairman of the meeting must ascertain the validity of the participation of the quotaholders, verify the regularity of the call/s and the establishment of the meeting. The chairman of the meeting establishes the order of discussions and the voting procedures.
- 12.15 Each resolution of the General Meeting must be recorded in the minutes and signed by the chairman and secretary of the General Meeting. The Administrator/s is responsible for keeping a copy of the minutes.
- 12.16 The minutes must contain the following: place and date of the meeting, its agenda, name of the chairman and the record-keeping person, voting results, decisions made, statement of the chairman regarding the decision making.
- 12.17 The list of participants shall be attached to the minutes as well as the documentation concerning the convening of the General Meeting.
- 12.18 The minutes and the list of participants must be signed by the chairman and the record-keeping person.

#### **Article 13 - The administrator/s**

- 13.1 The Company is administered by one or more Administrators, who shall act jointly. Unless the General Meeting dismisses them or they resign, the Administrators are appointed for a term of up to 5 (five) years. The Administrators may be reappointed.
- 13.2 The Administrators shall represent the Company toward third parties subject to and in accordance with the terms and provisions under item 13.3 below and /or appointment act shall have all powers of ordinary and extraordinary management of the Company, except for those powers that are reserved to other bodies of the Company as per these Articles of Association or applicable law.
- 13.3 The Administrator/s of the Company shall be granted specific powers. To this purpose, the Administrators shall undertake any transaction, enter into, renew,



terminate any agreement or contract, undertake any action, obligation, undertaking, perform any other action, in any case, each of which up to the amount of EUR 100,000 (hundred thousand Euro) or equivalent amount in other currency. For any other transaction, agreement, contract, action, obligation and undertaking over the above amount, the consent of General Meeting is required.

- 13.4 The Administrator/s shall perform his/their duties and activities in accordance with applicable legislation and Company's corporate acts.

#### **Article 14- Public Certified Accountant**

- 14.1 If necessary or requested by law or adopted by the General Meeting, the audit of the financial statements and accounting books of the Company shall be performed by one or more certified public accountants.

- 14.2 The certified public accountant shall have the responsibilities provided in the applicable law.

### **TITLE IV FINANCIAL YEAR, FINANCIAL STATEMENTS, DISTRIBUTION OF PROFITS**

#### **Article 15 - Financial year and statements**

- 15.1 The financial year commences on January 1<sup>st</sup> and closes on December 31<sup>st</sup> of each year.
- 15.2 The first financial year commences on the registration date of the Company with the National Business Center and ends on December 31<sup>st</sup> of the same year.
- 15.3 The annual balance sheet, financial statements, inventory, reports of the director and certified public accountant (if appointed) are approved by the General Meeting.
- 15.4 The documents related to the financial year must be approved within 6 (six) months from the end of the financial year.

#### **Article 16- Profits**

- 16.1 Profits resulting from the annual balance sheet, after deducting up to 10% (ten percent) for the legal reserve of the Company's capital, and deducting all the sums the General Meeting has decided to set aside, are distributed to the quotaholders in proportion to their quotas.
- 16.2 The General Meeting may decide to create extraordinary or special reserves for specific purposes or to postpone the distribution of the profits – in whole or in part.

### **TITLE V DISSOLUTION AND LIQUIDATION**

#### **Article 17 - Dissolution**

The Company may be dissolved by resolution of the General Meeting or in the cases provided by law.

#### **Article 18 - Liquidation**

- 18.1 In case the Company is dissolved, it must be liquidated.
- 18.2 In order to manage this procedure, the General Meeting appoints one or more liquidators, who will draft the final liquidation report on the assets and liabilities of the Company, the liquidation operations as well as the time necessary for the liquidation.



- 18.3 At the end of the liquidation procedure, the General Meeting will resolve on the final balance sheet, the work performed by the liquidator/s and termination of the liquidation process.
- 18.4 Following the payment of the creditors and collection of the outstanding credits, liquidator/s will distribute the final amount, resulting from the liquidation, to the quotaholders, in proportion to their quotas.

**TITLE VI  
MISCELLANEOUS**

**Article 19 – Dispute resolution**

19.1 All disputes arising from or in any way connected or related to the interpretation and/or execution of these Articles of Association, between the quotaholders (except disputed regarding issues not related to the Company) or between one or more quotaholders and the company, will be solved in an amicable way and settled directly between the interested parties.


19.2 If an amicable settlement of the dispute is not reached, the dispute shall be settled by the Court of Tirana, Albania.

**Article 20 - Language**

The Articles of Association are executed in 3 (three) copies in Albanian and English language. For every controversy arising from the execution and/or interpretation of the present instrument, the English version will be binding and the only one having legal effect.

\* \* \*

QUOTAHOLDER



For MEDISON PHARMA TRADING AG

INTERPRETER





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER VALBONA SH. SELIMI**



V2021052730340039562

**DATE 05/07/2021  
NR REP 4664**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 05.07.2021 para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, ne zyrën në adresën Tirane, NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqiten personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Artur Asllani, atësia Bashkim, amësia Sheqere, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Zh.Dark; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 12/08/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036542505 dhe nr. personal H30812127J , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Gerta Ylli, atësia Suad, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë A. Moisiu 36/2/22; Njësia Administrative Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 27/06/1975, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036313550 dhe nr. personal H55627133F , ne cilesine e perkthyeses.

Te cilet nenshkruan para meje noteres aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise 'Medison Pharma Albania' shpk, bashkëlidhur ketij vertetimi noterial.

Unë Noterja pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

VALBONA SH. SELIMI



A large, stylized handwritten signature in blue ink, corresponding to the name Valbona Sh. Selimi.